



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

PERSPEKTIVA RURALE E ZGJEDHJEVE LOKALE 2025

FOKUSI MBI PRIORITETET
GJINORE, E TË RINJËVE
DHE MJEDISORE

Shkup, 2025

E zbatuar nga:



International Foundation
for Electoral Systems

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	2
2.	Përfaqësimi i çështjeve gjinore dhe fuqizimi i grave në programet zgjedhore të kandidatëve për kryetarë komunash në komunat rurale	4
2.1	Përfshirja e fushës.....	4
2.2	Gjetjet përgjithshme të analizës	5
2.3	Shqyrtimi i angazhimeve dhe masave thelbësore dhe të cilat janë ndarë në mënyrë të veçantë.....	5
2.4	Përfundime dhe rekomandime	6
3.	Përfaqësimi i çështjeve rinore dhe pjesëmarrja e të rinjve në programet zgjedhore të kandidatëve për kryetarë të komunave në komunat rurale.....	7
3.1	Përfshirja e fushës.....	7
3.2	Gjetjet e përgjithshme të analizës	8
3.3	Shqyrtimi i masave dhe angazhimeve thelbësore të ndara në mënyrë të veçantë	9
3.4	Përfundime dhe rekomandime	14
4.	Përfaqësimi i mjedisit jetësor dhe zhvillimit rural në programet zgjedhore të kandidatëve për kryetarë të komunave rurale	15
4.1	Përfshirja e fushës.....	15
4.2	Gjetjet e përgjithshme të analizës	17
4.3	Shqyrtimi i masave dhe angazhimeve thelbësore të ndara në mënyrë të veçantë	17
4.4	Përfundime dhe rekomandime	25
	Shtojca 1 – Pasqyra e kandidatëve për kryetar komune në komunat e synuara	27
	Shtojca 2 – Emrat dhe shkurtesat e subjekteve politike.....	30

Programi për mbështetje zgjedhore është projekt i Qeverisë së Zvicrës i zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES). Përmbajtja dhe opinionet në këtë botim nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë pikëpamjet e Qeverisë së Zvicrës dhe Fondacionit ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES).

1. Hyrje

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zgjedhjet lokale u mbajtën në vitin 2025. Zgjedhjet lokale u realizuan në dy raunde, me raundin e parë që është mbajtur më 19 tetor dhe raundin e dytë që është mbajtur më 2 nëntor. Gjatë fushatës parazgjedhore për kryetarë komunash dhe këshilltarë të komunës në 80 komuna në vend dhe Qytetin e Shkupit, qytetarët patën mundësinë të njihen nga afër me përcaktimet strategjike dhe qëllimet e kandidatëve për kryetar komune, si dhe prioritetet e kandidatëve për këshilltarë nga partitë politike dhe koalicionet, si dhe listat dhe opsionet e pavarura. Kjo analizë shqyrton ofertën e partive politike në zgjedhjet lokale në vitin 2025 kundrejt nevojave të zbuluara në komunat e zgjedhura rurale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Rreth 70% e territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të përcaktohet si territor rural, me rreth 41.24% të popullsisë së përgjithshme në shtet që jeton në zonat rurale. Zonat rurale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dallojnë në mënyrë të konsiderueshme në karakteristikat sociale, ekonomike dhe demografike. Ekzistojnë sfida të shumta me të cilat përballen komunitetet rurale, duke filluar nga infrastruktura e cila nuk është e zhvilluar mjaftueshëm, mungesa e ujit të pijshëm, mungesa e sistemeve të kanalizimeve, qasja e kufizuar në arsimin fillor dhe të mesëm, mungesa e mundësive për arsim gjithëpërfshirës dhe mundësi të kufizuara për zhvillim kulturor. Në fakt, sipas hulumtimit “Jeta në fshatrat tona¹”, një e pesta e popullsisë rurale ose 24,2% jeton nën shkallën e rrezikut të varfërisë në vitin 2017, ku kjo normë tani vlerësohet më e lartë si rezultat i pandemisë me KOVID 19 dhe sfidave ekonomike. Furnizimi me ujë cilësor për popullsinë mbetet një sfidë për disa nga zonat rurale. Në fakt, 79% e popullsisë së përgjithshme në shtet furnizohet me ujë përmes ndërmarrjeve publike komunale, por në disa fshatra respektivisht zona rurale, banorët nuk kanë qasje në ujë të pijshëm cilësor. Të dhënat tregojnë se vetëm 17,7% e popullsisë rurale ka kanalizim publik, 8,9% nuk kanë instalim për largimin e ujërave të zeza. Gjithashtu, vetëm 10% e banorëve në fshatra apo zona rurale janë përdorues të shërbimeve të mbetjeve, me çrast situata e përgjithshme e menaxhimit të mbetjeve është e pavolitshme për shkak të infrastrukturës dhe pajisjeve të pamjaftueshme të menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e zonave rurale nuk kanë sistem kanalizimi dhe në shekullin 21 përdoren gropa septike dhe ka shkarkim të pakontrolluar të ujërave të zeza. Qasja në infrastrukturën rrugore është e vështirë në fshatrat më të vogla dhe më pak të zhvilluara, ku zonat rurale gjithashtu përballen me qasje të kufizuar në transport për shkak të disponueshmërisë së vështirë të shërbimeve të transportit. Në zonat rurale, numri i ambulantave shëndetësore të kujdesit parësor është në rënie, ndërsa farmacitë dhe klinikat stomatologjike gjenden vetëm në komunat më të mëdha. Nuk ka pothuajse asnjë institucion kulturor dhe një pjesë e popullsisë nuk ka as qasje në objekte sportive ose kënde lojërash. Megjithëse ka programe shtetërore dhe donatore që mbështesin zhvillimin lokal, bujqësinë dhe turizmin rural, ato shpesh janë të fragmentuara dhe të pamjaftueshme për të ndryshuar në mënyrë sistematike pamjen. Për shkak të mungesës së vendeve të punës dhe perspektivave, pjesa e madhe e të rinjve po largohen në Shkup ose jashtë vendit, gjë që zvogëlon më tej atraktivitetin e zonave rurale për të jetuar. Megjithatë, këto komuna kanë potencial të konsiderueshëm – mjedis jetësor më të pastër, shpenzime më të ulëta jetese, mundësi për bujqësi të qëndrueshme dhe ekoturizëm – të cilat mund të bëhen realisht tërheqëse nëse ofrohen investime më të qëndrueshme, infrastrukturë më të mirë dhe shërbime moderne lokale.

¹“Jeta në fshatrat tona – sfida dhe mundësi” Shoqata për zhvillimin rural Grupi lokal për veprim AGRO LIDER Krivogashtani, autor: Marina Tosheska,

Në fokusin e analizës janë tre fusha kryesore që tradicionalisht janë marginalizuar në programet e partive politike dhe relativisht rrallë të pranishme në ofertën në nivelin e komunave rurale, si më poshtë:

1. Çështjet gjinore dhe fuqizimi i grave
2. Përfshirja e të rinjve
3. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe zhvillimi rural

Përveç rëndësisë së këtyre çështjeve në zonat rurale, përzgjedhja e këtyre prioriteteve tematike u motivua nga nevoja për të tërhequr vëmendjen e politikanëve për çështjet që tradicionalisht marrin trajtim sipërfaqësor në programet zgjedhore. Këto çështje janë gjithnjë e më të rëndësishme sepse popullsia e re po lëviz gjithnjë e më shumë nga vendet rurale, fshatrat kërcënohen me zhdukje dhe braktisje, ndërsa mundësitë për gratë në zonat rurale janë veçanërisht të vështira dhe të pavolitshme. Çështjet gjinore dhe përfshirja e të rinjve nuk marrin gjithmonë një fokus të veçantë, kështu që kjo analizë do të mbulojë gjithashtu masat ndërsektoriale nëse ato kanë të bëjnë me gratë dhe të rinjtë. Në këtë analizë, ishte gjithashtu e një rëndësie të veçantë të perceptohej qasja e kandidatëve ndaj çështjeve në fushën e mjedisit jetësor dhe zhvillimit rural si zona për të cilat, veçanërisht në komunat rurale, pritet të propozohen masa të fokusuara për zhvillim dhe avancim. Një konstatim i përbashkët për të gjitha programet zgjedhore të analizuara është se ato nuk përfshijnë të dhëna për kornizat financiare për realizimin e programeve, prandaj analiza nuk mund të përqendrohet edhe në këtë pjesë. Vetëm në një pjesë të vogël të programeve mund të gjenden burime të supozuara të financimit për disa projekte.

Sipas të dhënave, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka 1758 zona rurale², dhe sipas hartës së komunave ka gjithsej 38 komuna rurale³, ku janë zgjedhur 10 komuna më të mëdha nga njësitë e ndryshme zgjedhore nga numri i përgjithshëm i komunave rurale. Më konkretisht, analiza përfshiu komunat Saraj, Studeniçan, Likovë, Çeshinovë-Obleshevë, Novaci, Vasilevë, Qendër Zupë, Dolnen, Vrapçishtë dhe Tearcë. Një pasqyrë e detajuar e komunave sipas njësive zgjedhore në të cilën analiza e përqendruar është dhënë në Shtojcën 1 së bashku me numrin e përgjithshëm të kandidatëve për kryetar komune dhe opsionet politike që ata përfaqësojnë (partitë politike, koalicionet ose kandidatët e pavarur). Në zgjedhjet lokale në këto 10 komuna kanë marrë pjesë gjithsej 34 kandidatë për kryetar komune dhe gjatë fushatës parazgjedhore është tërhequr një kandidaturë nga një kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Sarajit.

Në këto zgjedhje lokale, qasja në programet dhe materialet e shkruara zgjedhore dallonte midis kandidatëve. Kandidatët përdorën mënyra të ndryshme për të komunikuar premtimet zgjedhore duke filluar nga programet e shkruara, pasqyra e premtimeve zgjedhore në rrjetet sociale, video me fragmente nga programet zgjedhore, fletushka dhe video promovuese pa mbulim të veçantë të premtimeve zgjedhore dhe përcaktimeve programuese. Programet dhe materialet e tjera u siguruan përmes hulumtimit të zyrës, kontakteve të drejtpërdrejta me disa nga partitë që morën pjesë në zgjedhje dhe monitorimit të mediave sociale, ku metoda më efektive e komunikimit të premtimeve

² Lista e zonave rurale, në dispozicion në: <https://ipard.gov.mk/wp-content/uploads/2016/10/%D0%9F%D0%A0%D0%98%D0%9B%D0%9E%D0%93-1-%D0%9B%D0%98%D0%A1%D0%A2%D0%90-%D0%9D%D0%90-%D0%A0%D0%A3%D0%A0%D0%90%D0%9B%D0%9D%D0%98-%D0%9F%D0%9E%D0%94%D0%A0%90%D0%A7%D0%88%D0%90.pdf>

³ Harta e komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në: [https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%9F%D0%BE%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%BE%D1%82%D0%B5%D0%BA%D0%B0%D0%9A%D0%B0%D1%80%D1%82%D0%B0%D0%BD%D0%B0%D1%83%D1%80%D0%B1%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B8%D1%80%D1%83%D1%80%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D0%BF%D1%88%D1%82%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D0%B2%D0%BE%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0%2013\).svg](https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%9F%D0%BE%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%BE%D1%82%D0%B5%D0%BA%D0%B0%D0%9A%D0%B0%D1%80%D1%82%D0%B0%D0%BD%D0%B0%D1%83%D1%80%D0%B1%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B8%D1%80%D1%83%D1%80%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D0%BF%D1%88%D1%82%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D0%B2%D0%BE%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0%2013).svg)

zgjedhore ishte ajo ku programet zgjedhore u shpallën publikisht në një vend. Kjo analizë përfshiu gjithsej 24 programe dhe materiale zgjedhore (video, deklarata në mediat sociale, intervista dhe postime) që ishin në dispozicion. Disa nga kandidatët nuk kanë pasur respektivisht nuk kanë ndarë një program apo ndonjë material tjetër të shkruar për nevojat e kësaj analize.

2. Përfaqësimi i çështjeve gjinore dhe fuqizimi i grave në programet zgjedhore të kandidatëve për kryetarë komunash në komunat rurale

2.1 Përfshirja e fushës

Çështja e çështjeve gjinore dhe fuqizimi i grave në këtë analizë mbulon të gjitha qëllimet dhe masat që adresojnë në mënyrë specifike gratë si grup, por gjithashtu i referohet masave nga fusha të ndryshme përmes të cilave i jepet trajtim i veçantë grave (siç janë disa masa ekonomike ose sociale). Problemet me të cilat ballafaqohen gratë në Maqedoni janë të rrënjësura në konceptet tradicionale dhe të kuptuarit tradicional të rolit të gruas në familje dhe më gjerë në shoqëri. Kjo është veçanërisht e theksuar në zonat rurale, ku dominon perceptimi i një gruaje si amvise që duhet të kujdeset për shtëpinë, fëmijët, personat e moshuar dhe të punojë në bujqësi. Në këto mjedise, nuk mendohet për barazinë e saj me burrin dhe pavarësinë e saj ekonomike. Në fakt, për fat të keq, një numër i vogël i grave në zonat rurale janë pronare të pronave bujqësore, ato nuk marrin asnjë pagesë për detyrat e shtëpisë, as për kujdesin ndaj fëmijëve dhe personave të moshuar. Qasja e grave në shërbimet sociale dhe shëndetësore është e vështirë. Këto përfshijnë, për shembull, shërbimet gjinekologjike shëndetësore, të cilat pjesërisht duhet të jenë pa pagesë për gratë dhe janë kryesisht të disponueshme. Këto shërbime janë të kufizuara veçanërisht në zonat rurale sepse nuk ka mjaft institucione shëndetësore dhe ambulante për të përmbushur nevojat shëndetësore të grave. Barazia gjinore është një sfidë në fshatra dhe zona rurale dhe të dhënat tregojnë se hendeuku për qasje në resurse, si dhe qasja në mundësi dhe mbështetje për fuqizimin socio-ekonomik të burrave dhe grave në zonat rurale po rritet. Siç thuhet për gjendjen e grave në zonat rurale: "Pjesëmarrja e grave në marrjen e vendimeve në familje, por edhe pjesëmarrja e tyre në krijimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në nivel lokal është shumë e ulët, dhe një pjesë e vogël e komunave rurale në politikat e tyre lokale krijojnë programe dhe masa specifike gjinore që do të lejonin plotësimin e nevojave të grave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Nga numri i përgjithshëm i grave që jetojnë në fshatra, 58% nuk kanë të ardhura personale, që është dy herë më shumë se popullsia mashkullore në fshatra. Edhe kur puna e një gruaje paguhet, ata fitojnë vetëm 33% të asaj që fitojnë burrat në të njëjtin sektor."⁴ Në bazë të Ligjit për mundësi të barabarta për burrat dhe gratë,⁵ njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë detyrimin të krijojnë Komisionin për mundësi të barabarta si organ i përhershëm dhe të emërojnë koordinator (e) dhe zëvendëskoordinator (e) për mundësi të barabarta. Këto organe dhe pozita krijohen në të gjitha komunat, por jo kudo janë bërë shpërndarjet e duhura rreth detyrave dhe rolit të këtyre komisioneve dhe koordinatoreve për mundësi të

⁴ Ibid referenca 1

⁵ Ligji për mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 6/2012; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/2014 xxx/2015; xxx/2021; xxx/2025; teksti i pastruar, në dispozicion në: https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2017/precisten%20tekst%202015%20na%20ZEM_nov.pdf

barabarta⁶. Duke u nisur nga kjo vendosje strukturore, është realiste të priten masa më konkrete në këtë fushë.

2.2 Gjetjet përgjithshme të analizës

Gjetja e përgjithshme e analizës së kryer të të gjitha programeve të siguruar tregon se **çështjet gjinore dhe fuqizimi i grave janë të përfaqësuar në mënyrë shumë modeste** në programet zgjedhore të kandidatëve për kryetarë të komunave. Ndërsa në disa nga programet zgjedhore në zgjedhjet e mëparshme parlamentare në vitin 2024⁷, çështjet gjinore dhe fuqizimi i grave u trajtuan si një përparësi e veçantë tematike, dhe kjo dha shpresë se një trend i tillë do të pasqyrohej në programet zgjedhore për zgjedhjet lokale, megjithatë gjetja e analizës për këto 10 komuna rurale është ende dëshpëruese. **Pjesa më e madhe (21 nga gjithsej 24) të programeve të analizuar, deklaratave, intervistave, etj. nuk ofrojnë ndonjë qasje strategjike dhe trajtim të çështjeve gjinore dhe fuqizimit të grave.** Ajo që mund të gjendet në shumicën e programeve janë **premtimet për ndërtimin e kopshteve për fëmijë** si një masë e tërthortë që do të ndikonte në aktivizimin e grave në tregun e punës dhe punësimin e tyre. Gjithashtu në disa programe ka **premtime të shpeshta për fëmijë për një të porsalindur, një fëmijë të tretë, etj** që prekin drejtpërdrejt gruan, por nuk ndihmojnë fuqizimin e saj dhe pjesëmarrjen e saj të drejtpërdrejtë në tregun e punës dhe proceset e marrjes së vendimeve. Në një pjesë të vogël të programeve përmenden gjithashtu **përpjekjet për të siguruar mbështetje për gratë në kujdesin për personat e moshuar dhe fëmijëve me nevoja të veçanta** përmes mbështetjes dhe/ose krijimit të qendrave të kujdesit për personat e moshuar.

2.3 Shqyrtimi i angazhimeve dhe masave thelbësore dhe të cilat janë ndarë në mënyrë të veçantë

Në gjashtë nga programet zgjedhore të analizuar, çështjet gjinore trajtohen në mënyrë specifike dhe mund të vërehen **masa më thelbësore**, të cilat shpjegohen më poshtë:

„Vizioni:

Gratë janë temeli i familjes, shoqërisë dhe zhvillimit të komunës. Mandati ynë me Flamur Gjolekën do të jetë mandat për fuqizimin e grave, barazinë dhe mundësitë e barabarta„.

Fragment nga programi i kandidatit për kryetar të Komunës së Dolnenit, Flamur Gjoleka

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të Komunës së Dolnenit nga Aleanca kombëtare për integrim (AKI), Flamur Gjoleka**, përfshihet një **Program për gratë**. Në kuadër të programit janë parashikuar masa në kuadër të katër fushave, të cilat paraqiten më poshtë:

⁶ Monitorimi i zbatimit të ligjit për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në kuadër të vetëqeverisjes lokale, Akcija Zdruzenska, në dispozicion në:

<https://zdruzenska.org.mk/wp-content/uploads/2010/01/Monitoringot-na-primenata-na-Zakonot-za-ednakvi-mozhnosti-na-zhenite-i-mazhite-vo-ramkite-na-lokalnata-samouprava-vo-Republika-Makedonija.pdf>

⁷ Analizë "Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale 20204" Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore

- **Fuqizimi ekonomik** ku parashikohet mbështetja për bizneset e vogla dhe zejtarinë e udhëhequr nga gratë, krijimi i një Fondi komunal për gratë sipërmarrëse dhe trajnimi profesional për aftësitë në bujqësi, turizëm rural dhe shërbime lokale.
- **Pjesëmarrja aktive në marrjen e vendimeve** ku parashikohet përfshirja e grave në këshillat e fshatrave dhe në komunë gjatë marrjes së vendimeve, si dhe krijimi i një Këshilli të veçantë për gratë.
- **Mirëqënia sociale dhe familjare** ku parashikohen projekte për punësimin e grave të papuna dhe nënave të vetme, mbështetje në kujdesin për personat e moshuar dhe fëmijët përmes qendrave komunale të kujdesit ditor, si dhe një fushatë për parandalimin dhe mbrojtjen e shëndetit të grave.
- **Edukimi dhe aktivizimi i grave dhe të rinjve** ku parashikohen kurse për vajzat e reja në teknologjinë dhe lidërshtipin e gjuhëve të huaja, si dhe promovimi i shembujve të grave të suksesshme.
- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të Komunës së Novacit nga Koalicioni Maqedonia Juaj e udhëhequr nga VMRO - Partia demokratike për unitetin kombëtar maqedonas (VMRO-DPMNE), Stevçe Stevanovski**, në kuadër të fushës tematike Komuna e fortë ekonomike për një jetë më të mirë të të gjithë qytetarëve, është parashikuar **një projekt i veçantë "Gratë në biznes"** ku komuna është planifikuar të sigurojë **mbështetje për sipërmarrjen femërore** përmes trajnimeve, granteve dhe qasjes së lehtësuar në kredi për bizneset e vogla familjare dhe bizneset vendase. Gjithashtu parashikohet të organizohen programe të veçanta për të lidhur gratë me kompani dhe tregje më të mëdha.
- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të Komunës së Çeshinovës – Obleshevës nga Koalicioni për zgjedhje lokale 2025 i udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), Goranço Kërstev**, gratë përmenden si një grup i veçantë i synuar në vizionin e programit me një angazhim për **përfaqësim më të madh të grave rurale në të gjitha segmentet e shoqërisë**. Përveç kësaj, ka një pjesë të veçantë në program për grupin e synuar të grave duke deklaruar se “gratë mund të përforcojnë veten ekonomisht përmes punësorive për artizanatin dhe punët e dorës, ushqimin organik dhe produktet tradicionale me paraqitje në tregjet lokale. Roli i tyre në komunitet mund të rritet përmes një forumi të grave dhe kujdesit shëndetësor përmes fushatave edukative dhe ambulancave të lëvizshme."
- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të Komunës së Qendër Zhupës nga Partia për lëvizjen e turqve në Maqedoni, Inaet Baki**, parashihet **masë konkrete prej 10.000 euro** për ndërmarrësi për gratë.
- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të Komunës së Tearcës nga AKI, Nazim Taipi**, parashikohet **mbështetje për gratë dhe sipërmarrësit e rinj** përmes trajnimit, mentorimit dhe fondeve të veçanta për ta.

2.4 Përfundime dhe rekomandime

Siç u përmend shkurtimisht në gjetjen e përgjithshme të analizës së programeve zgjedhore të kandidatëve për kryetar komune në dhjetë komunat rurale që janë lëndë e analizës, çështjet gjinore dhe fuqizimi i grave trajtohen në mënyrë shumë sipërfaqësore. Programet nuk ofrojnë masa thelbësore që do të përmirësonin barazinë gjinore dhe do të përforconin pjesëmarrjen e grave në proceset sociale dhe socio-ekonomike. Premtimet zgjedhore mbeten të kufizuara në masa të tërthorta, me një pjesë shumë të vogël të angazhimeve dhe masave të drejtpërdrejta në fushën e fuqizimit ekonomik, përfshirjes në marrjen e vendimeve, çështjeve sociale dhe arsimit. Pavarësisht ekzistencës së grupeve aktive dhe unioneve të grave në kuadër të partive politike, pjesa e tyre në

përfaqësimin dhe avokimin për nevojat e grave, dhe veçanërisht grave rurale, në përgatitjen e programeve zgjedhore është e padukshme ose minimale. Pozita e grave rurale në komunat që analizuam është përgjithësisht e vështirë, me mundësi të kufizuara për mbështetje, zhvillim dhe përparim. Përveç kësaj, mund të thuhet se në zonat rurale pozita e grave është e ngarkuar edhe me kuptime tradicionale të rolit të grave në shtëpi, dhe furnizimi i kufizuar i politikave dhe masave gjinore e bën gjendjen edhe më të vështirë.

Për të ndihmuar në trajtimin e çështjeve gjinore dhe përforcimin e pozitës së grave në nivel lokal, dhe veçanërisht në komunat rurale, rekomandohet që opsionet politike që drejtojnë përfaqësuesit e tyre në zgjedhjet lokale, si dhe kandidatët fitues të realizojnë:

- Analizë të legjislacionit dhe politikave nacionale për çështjet gjinore siç është Strategjia për barazi gjinore 2022 – 2027, me qëllim të ofrimit të angazhimeve dhe masave për lidhjen e programeve zgjedhore dhe komunale me këto politika me qëllim të përmbushjes së detyrimeve që komunat kanë në fushën e çështjeve gjinore, por edhe avancimin e pozitës së grave në nivel lokal.
- Konsultimet përmes mekanizmave institucional lokal të barazisë gjinore siç janë Komisionet për mundësi të barabarta dhe Koordinatorët/et për mundësi të barabarta në komuna për të diskutuar dhe zgjedhur masat që do të përfshihen në programet zgjedhore dhe komunale.
- Konsultime me shoqatat qytetare që punojnë me gratë dhe çështjet gjinore në komunat rurale, si dhe drejtpërdrejtë me gratë për të identifikuar nevojat reale dhe për t'i integruar ato në përputhje me rrethanat në programet zgjedhore dhe komunale.
- Reflektimi dhe shqyrtimi i nevojave të grupeve specifike të grave rurale si gratë e reja, gratë rome, gratë me nivel të ulët arsimor, gratë e rritura, etj. për të krijuar masa afirmative të përshtatura për këto grupe.

3. Përfaqësimi i çështjeve rinore dhe pjesëmarrja e të rinjve në programet zgjedhore të kandidatëve për kryetarë të komunave në komunat rurale

3.1 Përfshirja e fushës

Sipas Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore⁸, neni 3, grupmosha e të rinjve përfshin të gjithë personat e moshës 15 deri në 29 vjeç. Termi politika rinore, nga ana tjetër, përfshin politika, programe, shërbime dhe/ose aktivitete të ndryshme që synojnë të rinjtë për të realizuar potencialin e tyre të përgjithshëm. Pjesëmarrja rinore, nga ana tjetër, është një proces që lejon të rinjtë të marrin pjesë dhe së bashku të marrin vendime në lidhje me politikat dhe programet që drejtpërdrejt ose tërthorazi formësojnë jetën e të rinjve. Në kontekst të kësaj analize, u analizuan të gjitha angazhimet, masat dhe aktivitetet që u përfshinë drejtpërdrejt në fushën e të rinjve në kuadër të programeve zgjedhore ose ishin masa sektoriale që i referohen të rinjve.

Në kontekstin e zgjedhjeve lokale, është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje mekanizmave për përfaqësimin e të rinjve në nivel lokal, ku Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore

⁸ Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore, Gazeta zyrtare e RMV nr.10/2020

parashikon krijimin e Këshillave rinore lokale në kuadër të komunave si një organ këshilldhënës për të rinjtë. Edhe pse e themeluar ligjërisht, kjo dispozitë nuk zbatohet në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë vendin. Sipas monitorimit të zbatimit të Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore për vitin 2024, nga 81 komuna, këshillat e tilla janë themeluar në 28 komuna ose 34% të të gjitha komunave, dhe në 7 komuna procesi është në vazhdim⁹. Për komunat rurale, krijimi i këshillave rinor lokal është një sfidë e veçantë për shkak të pamundësisë për të përmbushur kriteret për ekzistencën e organizatave lokale të nxënësve, studentëve apo organizatave rinore lokale në territorin e komunës. Për më tepër, sipas të njëjtit ligj, formimi i qendrave rinore në nivel lokal parashikohet si detyrim i komunave, dhe aktualisht, sipas monitorimit të lartpërmendur, ka qendra të tilla në 14 komuna. Në lidhje me emërimin e nëpunësve për të rinj, 56 komuna caktuan nëpunës për të rinj.

Problemet e të rinjve në zonat rurale, në mënyrë të ngjashme me gratë, varen drejtpërdrejtë nga mundësitë e përcaktuara ekonomike, infrastrukture dhe zhvillimore. Më së shpeshti, problemet e të rinjve janë “të lidhura me kufizimin e ofertës kulturore bashkëkohore (mungesa e teatrit, kinemasë), mundësitë e kufizuara për sport dhe rekreacion, mungesa e arsimit dhe arsimit jashtë shkollës, infrastruktura e dobët publike dhe transporti publik, mënyra se si sektori publik menaxhon mbeturinat publike, prania dominuese e një mentaliteti lokal dhe paragjykimet që rrjedhin prej tij, ekonomia e pazhvilluar, të ardhurat e ulëta dhe sfidat ekzistenciale”¹⁰. Të rinjtë në zonat rurale kanë informacione të kufizuara dhe nuk janë të përfshirë sa duhet në iniciativat e zhvillimit të vetëqeverisjeve të tyre lokale që lidhen me jetën e të rinjve. Ata gjithashtu besojnë se kanalet e komunikimit me institucionet publike, para së gjithash vetëqeverisja lokale, duhet të jenë të dyanshme, të përmirësohen dhe të bëhen më efikase. Për më tepër, qëndrimet e tilla plotësohen nga analizat e organizatave të shoqërisë civile që kanë aktivitetet e tyre në zonat rurale, ku ata besojnë se prioritet është realizimi dhe zbatimi i Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore, si dhe përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së komunave dhe përfshirja e të rinjve në politikat lokale rinore.

3.2 Gjetjet e përgjithshme të analizës

Gjetja e përgjithshme e analizës së kryer të të gjitha programeve zgjedhore që u ofruan tregon se nuk ka pothuajse asnjë program që nuk përfshin aktivitete që lidhen me të rinjtë ose çështje specifike rinore. Trajtimi është i ndryshëm kur **në 16 nga gjithsej 24 programet e analizuara përfshihet një fushë e veçantë ose përparësi tematike e të rinjve** (me një fushëveprim të ngjashëm me atë të shpjeguar në pjesën 3.1 të kësaj analize), ndërsa në një numër më të vogël programesh parashikohen masa për të rinjtë në kuadër të fushave tematike. Trendi i **përmendjes së të rinjve si grup i synuar vazhdon në kuadër të fjalimeve hyrëse dhe vizioneve** të përfaqësuara në programet zgjedhore, por jo të gjitha programet që kanë përmendur të rinjtë në nivelin e angazhimit ose si grup i synuar përpunojnë më tej masa konkrete për ta. Është karakteristike që **një qëllim i përbashkët deklarativ i të gjithë kandidatëve është t'u mundësojë të rinjve në komuna të shohin të ardhmen e tyre këtu në vend dhe në komunën e tyre** dhe në këtë drejtim të shpjegojnë masat e propozuara për të rinjtë. Megjithatë, përvojat e deritanishme nga ciklet e tjera të zgjedhjeve lokale, si dhe nga zgjedhjet parlamentare,¹¹ tregojnë se **masat në përgjithësi janë shumë të ngjashme** nga cikli në

⁹Raport për monitorim për zbatimin e Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore për vitin 2023 Këshilli rinor nacional, 2024 në dispozicion në: https://www.nms.org.mk/wp-content/uploads/2025/08/NMSM-Monitoring-Izvestaj_MK_02_kor.pdf

¹⁰Analiza e nevojave dhe problemeve specifike të të rinjve në Pellagoninë rurale, Shoqata e qytetarëve për avancimin e proceseve zhvillimore Pro Lokal Manastir

¹¹ Analiza "Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024", Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore: <https://electoralsupportprogramme.mk/wp-content/uploads/2024/10/youth-mkd-1-1.pdf>

cikël, dhe është shumë e vështirë të bëhet një lidhje e drejtpërdrejtë dhe të përcaktohet nëse disa masa për të rinjtë kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe çfarë efektesh kanë **në kuptim të zvogëlimit të zhvendosjes së të rinjve**.

Edhe pse opsionet politike në këto zgjedhje lokale njohin të rinjtë dhe nevojat e tyre specifike, duhet theksuar se në disa programe në **kuadër të segmentit të të rinjve janë të përfaqësuara në përgjithësi aktivitetet në fushën e sportit dhe kulturës**, siç janë ndërtimi i qendrave sportive, sallave sportive, fushave sportive, ndërtimi i shtëpive të kulturës, ndërtimi dhe rinovimi i shkollave, mbështetja e manifestimeve kulturore rinore dhe shoqërive kulturore-artistike në të cilat të rinjtë janë anëtarë. Kjo qasje, e cila e redukton politikën rinore kryesisht në aktivitete sportive dhe kulturore, edhe pse është e nevojshme, nuk është plotësisht e përshtatshme sepse nuk adreson nevojat thelbësore dhe komplekse të të rinjve. Investimet në infrastrukturë janë të rëndësishme, por në vetvete nuk ofrojnë mundësi të përmirësuar për punësim, arsim cilësor, pjesëmarrje në vendimmarrje, mbështetje të shëndetit mendor ose qasje në shërbime moderne që të rinjtë i identifikojnë si prioritet. Kjo rezulton në politika të pamjaftueshme efektive që nuk kontribuojnë në mbajtjen e të rinjve në komunitet, as në përfshirjen e tyre afatgjatë zhvillimore.

Ndër masat e përfaqësuara në fusha të ndryshme tematike më së shpeshti gjenden:

- **masat për fuqizimin ekonomik të të rinjve, zhvillimin e potencialit të tyre sipërmarrës** (qendrat e biznesit dhe inkubatorët, mbështetja e bizneseve rinore, mbështetja e vendeve të punës së të rinjve)
- **masat nga arsimi** (bursa për nxënësit dhe studentët, fonde çmimesh për nxënësit dhe studentët më të mirë ose për të rinjtë e talentuar, mbështetje përmes sigurimit të materialeve mësimore, transport pa pagesë për nxënësit, investime në infrastrukturë si ndërtimi dhe rinovimi i shkollave për kushte më të mira për arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve)
- **mbështetje sociale** (subvencione për lejet e drejtimit të automjetit, mbështetje për çiftet e reja të martuara përmes masave të banimit dhe mbështetje financiare për të sapolindurit).

3.3 Shqyrtimi i masave dhe angazhimeve thelbësore të ndara në mënyrë të veçantë

Në 16 nga programet zgjedhore të analizuara, çështjet rinore dhe pjesëmarrja rinore trajtohen në mënyrë specifike, dhe në disa prej tyre mund të vërehen **masa më thelbësore**, të cilat shpjegohen më poshtë:

Komuna e Sarajit

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të Komunës së Sarajit, Muhamed Elmazi nga Koalicioni Vlen**, një nga shtatë arsyet pse do të votohet për këtë kandidat theksohet *“Themelimi i Qendrës rinore dhe kulturore në Saraj. Një hapësirë moderne për të rinjtë, kulturën, arsimin joformal dhe aktivitetet që ringjallin komunën”*(fragment nga programi). Gjithashtu, në një intervistë të dhënë për një media, kandidati shprehet se *“për të rinjtë tashmë janë realizuar takime me kompani inovative dhe janë përgatitur programe të qarta për subvencionimin e aktiviteteve të ndryshme.”*

Komuna e Likovës

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të Komunës së Likovës, Erkan Arifi nga AKI**, të rinjtë veçohen si prioritet i veçantë, dhe si masë thelbësore për të rinjtë, parashihet *themelimi i Këshillit rinor lokal*. Në kuadër të këtij programi, parashikohen masa shumë specifike edhe në kuadër të fushave të tjera tematike që prekin të rinjtë, si: *bursa për studentë (dhe atë për studentë me një mesatare mbi 8,00, studentë që studiojnë në fakultete deficitare dhe studentë nga familje me kushte të vështira sociale) dhe mbështetje financiare për nxënësit e shkollave të mesme dhe nxënësit e shkollave fillore që ndajnë vendet e para në garat komunale, rajonale dhe republikane*.

Çeshinovë-Obleshevë

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar komune Goranço Kërstev nga Koalicioni për zgjedhje lokale 2025 i udhëhequr nga LSDM**, ekziston një fushë e veçantë

Të rinjtë në fokus – Paradigmë e re për zhvillim të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm

- Ndërtojmë individë të shëndetshëm dhe me vetëdije demokratike*
- Të jemi fushë për zhvillim të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm në vend se të jemi fidanishte për botën*
- Të rinjtë për të ardhmen tonë dhe shpresën – banim që është lehtësisht i disponueshëm*

Fragment nga programi i kandidatit për kryetar komune Goranço Krstev

për zgjedhje lokale 2025 i udhëhequr nga LSDM, ekziston një fushë e veçantë **Të rinjtë në fokus – Paradigma e re për zhvillim të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, e cila përshkruan kryesisht përpjekjet për të mbështetur të rinjtë**. Në kuadër të vizionit qëndron: *“Komunë që do të jetë moderne, e gjelbër dhe e hapur për qytetarët, një vend ku të rinjtë do të duan të qëndrojnë për të jetuar një jetë dinjitoze.”* Programi përfshin angazhime dhe masa për të rinjtë në disa vende. Kështu, në vazhdim të vizionit, theksohet se *“të rinjtë janë*

resursi më i rëndësishëm që kemi”, por nuk ka zgjidhje, por vetëm një angazhim për të ofruar mbështetje dhe një shans për të rinjtë. Më tej në segmentin e shpërnguljes, ofrohen zgjidhje për të zvogëluar shpërnguljen e të rinjve, siç janë:

- garantimi i sigurimit social,
- shëndeti funksional,
- arsimi cilësor,
- përmbajtje interesante për të rinjtë, dhe
- parcela për shitje për banim individual dhe kolektiv të dedikuara për çifte të reja të martuara

Në kuadër të programit, ka një pjesë të veçantë për grupin e synuar të të rinjve, ku thuhet: *“Të rinjtë duhet t’u jepet mundësia për arsim shtesë përmes kurseve pa pagesë dhe mbështetjes digjitale, si dhe përfshirjes në gara sportive, kampe verore dhe ngjarje kulturore. Komuna gjithashtu mund të inkurajojë bujqësinë rinore me trajnime për prodhimin bashkëkohor dhe praktikën në kompanitë lokale”* (fragment nga programi).

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të komunës Jordance Kostadinov nga Koalicioni Maqedonia jote i udhëhequr nga VMRO-DPMNE**, ekziston një fushë e veçantë

investojmë në arsim dhe rini në komunën tonë, por masat e përfshira janë masa në fushën e arsimit siç janë ndërtimi/rindërtimi i shkollave dhe terreneve sportive, bursa për nxënës të talentuar dhe studentë që kanë fituar çmime në gara, por edhe masa sociale për bursa të nxënësve nga kategoritë e cënueshme dhe përfshirja e këtyre nxënësve në udhëtimet e fundjavës.

Komuna e Novacit

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar komune Lube Kuzmanovski nga Koalicioni për zgjedhje lokale 2025 i udhëhequr nga LSDM**, në pjesën hyrëse thuhet: "Prioriteti im do të jetë ndërtimi i një sistemi efikas në të cilin të rinjtë nga komuna jonë do të integrohen duke krijuar kushte dhe përfshirje të drejtpërdrejtë në mënyrë që të maksimizojnë potencialin e tyre krijues dhe inovativ" (fragment nga programi). Për më tepër, ky kandidat ka përfshirë në fokus një pjesë të veçantë të rinjtë në fokus – një paradigmë e re në të cilën ka disa masa duke përfshirë masa thelbësore për të rinjtë siç është krijimi i një Këshilli rinor lokal, por edhe masa që u përkasin prioritetëve të tjera tematike siç janë arsimi

***Masat përfshijë:** Subvencionet për kalimin e testit për drejtimin e automjetit deri në 26 vite, Formimi i habeve (qendrave) për të rinj, Grante për projekte rinore, trajnime pa pagesë për aftësi digjitale dhe marketing, ndihmë financiare për fëmijë pa kujdes prindëror, racion të shëndetshëm dhe cilësor për çdo nxënës, uniforma nxënësish për të gjithë nxënësit, shpërblieme për nxënësit e gjeneratës, racion pa pagesë, transport dhe racion për nxënësit me aftësi të kufizuara, orë pa pagesë për kategoritë e rrezikuara, digjitalizimi i qendrës rinore kulturore, ndërtimi i pishinës të hapur dhe orë pa pagesë për not, programe për punësim dhe punë praktike, mbështetje për projekte kulturore dhe shkencore me ndihmë financiare për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe organizimi i turave me biçikletë.*

Fragment nga programi i kandidatit për kryetar komune Lube Kuzmanovski

dhe çështjet sociale.

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar komune Stevçe Stevanovski nga Koalicioni Maqedonia jote e udhëhequr nga VMRO-DPMNE**, edhe pse nuk ka fushë të veçantë për të rinjtë, ekzistojnë disa **projekte të veçanta rinore** në fusha të ndryshme që janë specifike dhe të shpjeguara në detaje.

Projektet rinore janë përfshirë në pjesën e zhvillimit ekonomik siç është **projekti i inkubatorit të biznesit "Biznesi im, komuna ime"** ku një inkubator do të funksiononte në një hapësirë të ofruar nga komuna si një "sistem me një sportel"

*Në projektet prioritare si projekt për të rinj është paraparë e **Fondi për të rinj dhe inovacione („Të rinj me ide“)** të cilin do të formonte komuna me qëllim që të jap grante dhe mbështetje mentorale për sipërmarrësit e rinj, nxënësit dhe studentët që kanë ide inovative afariste. „Çdo aplikant do të mund të marrë mbështetje financiare për biznese startup, dhe në mënyrë shtesë do të organizohen trajnime për mbajtjen e kontabilitetit, marketingut dhe shitjes digjitale. Fondi do të punojë në partneritet me dhomat ekonomike, bankat lokale dhe organizatat joqeveritare“.*

Fragment nga programi zgjedhor i kandidatit Stevçe Stevanovski

ku çdo sipërmarrës mund të marrë një mentor, kontakte biznesi dhe qasje tek investitorët. Në fushën e bujqësisë, është **paraparë projekti “Të rinjtë në bujqësi”** ku parashikohen si programe dhe mbështetje për bujqit e rinj me qëllim që të inkurajohet qëndrimi dhe investimi i tyre në zonat rurale. Në segmentin e arsimit, është paraparë projekti **“Qendra për njohuri dhe aftësi praktike”** ku është parashikuar si një *“qendër multifunksionale që do të lidhë shkollat e mesme, fakultetet dhe kompanitë lokale. Qendra do të ofrojë trajnime praktike për profesionet më të kërkuara (IT, marketing digjital, inxhinieri elektrike respektivisht elektroteknikë, teknologji bujqësore), si dhe programe për rikualifikimin e personave të papunë. Një pjesë e hapësirës do t'i kushtohet coworking dhe startapeve.”* Projekti **“DIGITAL HUB – komuna e së ardhmes”** parashikohet më tej si një qendër digjitale ku do të mbledhen startapet dhe nxënësit/studentët që punojnë në zgjidhjet digjitale. Qendra do të ofrojë hapësirë coworking, internet me shpejtësi të lartë, mentorë dhe qasje në fonde. Në kuadër të projektit **“Qendra rinore kreative”**, është planifikuar mbështetja për qendrën rinore tashmë të hapur ku *“të rinjtë do të kenë mundësi për shprehje artistike – hapësirë për bende muzikore, studio vallëzimi, fotografi, art digjital dhe prodhim video. Qendra do të mbështetet nga komuna, por do të udhëhiqet nga të rinjtë përmes këshillave rinore”* (fragment nga programi). Në këtë kandidat parashikohen edhe **subvencione për leje për drejtimin e automjetit për të rinjtë deri në 26 vjeç**. Gjithashtu, në fushën e arsimit parashihen bursa për nxënësit dhe studentët, bursa për nxënësit nga kategoritë e rrezikuara sociale, krijimi i fondit të veçantë për bursa, si dhe projekte të shumta për rindërtimin e shkollave dhe futjen e këshillimit psiko-social për nxënësit në shkolla.

Komuna e Vasilevës

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të komunës Vanço Novoselski nga Koalicioni për zgjedhje lokale 2025 i udhëhequr nga LSDM**, në fjalimin hyrës përmenden të rinjtë dhe mbështetja e tyre me qëllim të edukimit shtesë në **përputhje me nevojat e biznesit**. Për më tepër, në Vizion, kandidati shprehet se është e rëndësishme që të rinjtë të ndihmohen për të **marrë trajnime, për të pasur investime të reja në sport dhe kulturë, si dhe për të siguruar mbështetje për të rinjtë e angazhuar në bujqësi**. Ngjashëm me kandidatët e tjerë nga ky opsjon politik, është paraparë **fushë e veçantë Të rinjtë në fokus** në të cilën janë zhvendosur disa projekte, disa prej të cilave u përkasin prioritetëve të tjera tematike. Projektet e përfshira janë: *Prezantimi i “Garancisë për të rinj – qasja në punë, trajnim ose praktikë, Krijimi i qendrave sociale rinore për mentorim dhe zhvillim personal, Krijimi i Fondit për inovacione rinore, Organizimi i programeve verore për vullnetarizëm dhe aktivizëm lokal dhe Platforma Digjitale “e-Youth”* (fragment nga programi).
- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të komunës Slave Andonov nga Koalicioni Maqedonia jote e udhëhequr nga VMRO-DPMNE**, është përfshira fusha **Investojmë te të rinjtë dhe arsimin në komunën tonë**, ngjashëm me kandidatët e tjerë nga partia, megjithatë fusha përfshin projekte për ndërtimin dhe rindërtimin e shkollave dhe oborreve shkollore, ndërsa masat sociale parashikojnë subvencionimin e nxënësve. Është interesante se ky program përfshin edhe **propozime nga qytetarët** në të cilët është dhënë propozim për ndërtimin e **një qendre multifunksionale** në vendbanimin Dobroshinci që duhet të shërbejë edhe si argëtim për të rinjtë.

Komuna Qendër Zupë

- Në programin zgjedhor të **kandidatit Inaet Baki nga Partia për lëvizjen e turqve në Maqedoni**, në fjalimin hyrës është bërë angazhim për të mbështetur të rinjtë përmes

masave në arsim dhe mbështetje sociale. Si masë konkrete, parashikohen **grante deri në 10 000 euro për sipërmarrjen e të rinve dhe krijimin e një këshilli rinor.**

Komuna e Dolnenit

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar komune Isuf Sinani nga Koalicioni për zgjedhje lokale 2025 i udhëhequr nga LSDM**, në vizion është përfshirë një fjalim për të rinjtë. Ngjashëm me kandidatët e tjerë nga ky opsjon politik, ofrohet një pjesë e veçantë Të rinjtë në Fokus – Një paradigmë e re për zhvillim të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm që përfshin disa projekte në fushën e arsimit, mbështetjes sociale, sportit, etj.

„Të rinjtë janë faktor kryesor për funksionimin e Dolnenit. Energjia e tyre, kreativiteti dhe potenciali duhet të njihen dhe mbështeten. Prandaj do të punojmë në hapjen e mundësive të reja për arsim, punësim, sport dhe kulturë, që të krijojmë kushte që të rinjtë të mbesin dhe të zhvillohen në vendlindjen e tyre.“

Fragment nga programi i kandidatit për kryetar të komunës Isuf Sinani

por edhe masa thelbësore rinore si: “Krijimi i një Qendre Rinore në Dolnen, zhvillimi i një strategjie lokale rinore me Këshillin rinor lokal, pjesëmarrja aktive e të rinjve në këshillin e komunës, punëtoritë vjetore rinore për iniciativa”(fragment nga programi).

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar komune Flamur Gjoleka nga AKI**, parashikohet një program për të rinjtë. Në kuadër të programit janë përfshirë 4 pika me aktivitete specifike, si më poshtë:
 - **Punësimi dhe sipërmarrja rinore:** Krijimi i një Qendre rinore për inovacion dhe punësim, ku të rinjtë do të marrin trajnime praktike dhe mbështetje për idetë e biznesit; Subvencione dhe ndihmë për bizneset e reja të themeluara nga të rinjtë;
 - **Arsimi profesional dhe trajnimi:** Bashkëpunimi me shkollat dhe kompanitë profesionale për praktikën në vendin e punës; Kurse pa pagesë për teknologjinë, bujqësinë moderne dhe gjuhët e huaja.
 - **Kultura dhe sporti:** Investimi në terrene sportive, klube dhe aktivitete kulturore lokale; Organizimi i një festivali rinor komunal - çdo vit për artet, muzikën dhe sportet.
 - **Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve:** Krijimi i një këshilli rinor të komunës, i cili do të ketë zë në çdo vendim; Mbështetje për projektet e iniciuara nga të rinjtë, me mjete nga buxheti i komunës.

Qëllimi: Të rinjtë janë energjia dhe e ardhmja e komunitetit tonë. Gjatë mandatit tim, do të krijojmë kushte që ata të mbesin, të punojnë dhe zhvillohen këtu.

Fragment nga programi i kandidatit për kryetar komune Flamur Gjoleka

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar të komunës Sashko Veljanoski nga Koalicioni Maqedonia jote i udhëhequr nga VMRO-DPMNE**, ngjashëm me kandidatët e tjerë nga ky opsjon politik, **ekziston një pjesë e veçantë Investojmë në arsim dhe të rinjtë në komunën tonë**, por në atë pjesë nuk ka masa thelbësore për rindërtimin e shkollave, bursa për nxënës dhe studentë dhe subvencione për leje për drejtimin e automjetit.

Komuna e Vrapçishtit

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar komune Isen Shabani nga AKI**, është paraparë një **pikë e veçantë për mbështetjen e të rinjve**, e cila thotë se komuna do t'i përkushtohet *“ndërtimit të objekteve dhe qendrave rekreative për të rinj, krijimit të institucioneve për organizimin e ngjarjeve kulturore dhe artistike ku do të dominonte roli i të rinjve, krijimit të kushteve për avancimin e sportit në kuadër të Komunës së Vrapçishtit, etj.”*(fragment nga programi)
- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar komune Mehmet Seferi nga Koalicioni Vlen**, përmendet shkurtimisht aplikimi për **programe bashkëkohore për të rinjtë, studentët dhe nxënësit**.

Komuna e Tearcës

- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar komune Nazim Taipi nga AKI**, përfshihen masa konkrete rinore. Parashikohet **mbështetje për sipërmarrësit e rinj** përmes trajnimit, mentorimit dhe fondeve të veçanta. Planifikohet vendosja dhe prezantimi i:
 - **"Hapësirave publike dhe qendrave rinore:** Terrene sportive, qendra kulturore dhe teknologjike.
 - **Bursa komunale:** Për nxënësit me nota të larta, si motivim për të ardhmen".Sipas programit, **parashihet edhe përfshirja e të rinjve në marrjen e vendimeve** përmes krijimit të një **Këshilli rinor në komunë, si dhe formimit të një Qendre rinore të karrierës**, e cila do të lidhë të rinjtë me tregun e punës dhe do të organizojë një Panair të karrierës, i cili do të përfshijë të rinjtë dhe punëdhënësit potencialë.
- Në programin zgjedhor të **kandidatit për kryetar komune Daut Memishi nga Koalicioni Vlen**, parashikohet **një fushë e veçantë për të rinjtë**, e cila përfshin masa rinore, por edhe masa në fushën e kulturës, sportit dhe punësimit. Si masë **e veçantë, parashikohet ndërtimi i një qendre rinore multifunksionale në Tearcë**, e cila siguron hapësirë për aktivitete kulturore dhe sociale; kurse IT, gjuhë të huaja dhe trajnime praktike; Biblioteka digjitale dhe kënde për hulumtime; Hapësirë për bashkëpunim për të rinjtë të cilët punojnë në internet ose zhvillojnë startape. Në kuadër të masave për punësimin dhe sipërmarrësinë është paraparë arsimi profesional dhe trajnimi, **mbështetja për startapet rinore, Platforma “Rinia për Tearcën”**. Në kuadër të **masave për kulturën**, parashikohet *mbështetja e manifestimeve kulturore dhe përfshirja e të rinjve në ngjarjet kulturore, mbështetja e grupeve të artit si dhe hapësira për ekspozita dhe kinema verore*. Në **fushën e sportit**, parashikohen masa për *rindërtimin e terreneve sportive dhe mbështetjen e klubeve sportive dhe ligave komunale*.

3.4 Përfundime dhe rekomandime

Analiza e premtimeve të përfshira, angazhimeve, masave për të rinjtë dhe pjesëmarrjes së të rinjve në programet zgjedhore të kandidatëve për kryetar komune në dhjetë komunat rurale tregon se kandidatët i perceptojnë të rinjtë si një target grup të veçantë dhe të rëndësishëm me nevojat dhe kërkesat e tyre specifike. Oferta që mund të gjendet në programet zgjedhore është e ndryshme si në cilësi ashtu edhe në fushëveprim dhe varion nga projekte rinore të qarta dhe të menduara mirë, deri vetëm në përmendjen deklarative të të rinjve dhe rëndësinë e tyre në shoqëri. Qasjet ndaj programeve zgjedhore janë mbizotëruese, sipas të cilave propozohen një numër masash dhe aktivitete, pa bërë një analizë më të thellë se sa realist është realizimi i tyre në një mandat dhe

